

**PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.**

**Pasqyrat Financiare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

**Përmbajtja:**

	<b>Faqe</b>
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020	2
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	3
Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	4
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	5
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	6 – 15

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Pasqyra e pozicionit financiar


më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

Aktivet	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>I. Aktivet afatshkurtra</b>			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	4	26,569,666	4,823,855
Aktive financiare afatshkurtra	5	57,990,948	62,705,582
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	6	27,497,128	7,019,783
Parapagim tatim-fitimi	7	-	1,797,492
<b>Total i aktiveve afatshkurtra (I)</b>		<b>112,057,743</b>	<b>76,346,713</b>
<b>II. Aktivet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	8	14,217,497	15,738,502
Aktive afatgjata jomateriale	9	1,008,448	1,348,935
<b>Totali i aktiveve afatgjata (II)</b>		<b>15,225,945</b>	<b>17,087,437</b>
<b>Totali i aktiveve (I + II)</b>		<b>127,283,688</b>	<b>93,434,150</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali</b>			
<b>I. Detyrimet afatshkurtra</b>			
Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet	10	95,280,984	83,352,602
Dividentët për t'u paguar		5,613,027	15,012,305
Detyrim tatim fitimi	7	3,636,455	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)</b>		<b>104,530,465</b>	<b>98,364,907</b>
<b>II. Detyrimet afatgjata</b>			
Grantet dhe të ardhurat e shtyra	11	227,056	302,741
<b>Totali i detyrimeve afatgjata (II)</b>		<b>227,056</b>	<b>302,741</b>
<b>Totali i detyrimeve (I + II)</b>		<b>104,757,521</b>	<b>98,667,648</b>
<b>III. Kapitali</b>			
Kapitali aksioner		100	100
Fitimi/(Humbja) e akumuluar		(5,233,449)	(165)
Fitimi i vitit		27,759,516	(5,233,434)
<b>Totali i kapitalit (III)</b>	1	<b>22,526,167</b>	<b>(5,233,499)</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)</b>		<b>127,283,689</b>	<b>93,434,150</b>

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan nga PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë:

  
PwC Consulting Shpk  
Administratori

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

		31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shitjet neto	12	209,713,470	202,125,305
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	13	639,590	668,138
<b>Totali i të ardhurave</b>		<b>210,353,059</b>	<b>202,793,443</b>
Materialet e konsumuara	14	(939,750)	(1,627,445)
Kosto e punës			
-pagat e personelit	15	(72,002,448)	(86,274,075)
-shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	15	(8,946,549)	(10,493,076)
Amortizimet	8,9	(3,186,259)	(3,507,051)
Shpenzime të tjera	16	(90,797,200)	(103,830,293)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(175,872,206)</b>	<b>(205,731,939)</b>
<b>Fitimi nga veprimtaria kryesore</b>		<b>34,480,854</b>	<b>(2,938,496)</b>
<b>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare</b>			
Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit, neto	17	(437,544)	(1,542,609)
<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare</b>		<b>(437,544)</b>	<b>(1,542,609)</b>
<b>(Humbja)/ Fitimi para tatimit</b>		<b>34,043,310</b>	<b>(4,481,105)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	7	(6,283,793)	(752,329)
<b>Fitimi neto i vitit financiar</b>		<b>27,759,516</b>	<b>(5,233,434)</b>

Pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

**Pasqyra e ndryshimeve në kapital**  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë)

	Kapitali aksioner	(Humbje)/Fitime të akumuluar	Totali
<b>Më 31 dhjetor 2016</b>	<b>100</b>	<b>18,915,767</b>	<b>18,915,867</b>
Fitimi (humbja) e vitit		(22,275,706)	(22,275,706)
Dividentët e paguar		(11,848,078)	(11,848,078)
<b>Më 31 dhjetor 2017</b>	<b>100</b>	<b>(15,208,017)</b>	<b>(15,207,917)</b>
Fitimi (humbja) e vitit		25,107,188	25,107,188
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>100</b>	<b>9,899,171</b>	<b>9,899,271</b>
Emetim i kapitalit aksioner			
Fitimi (humbja) e vitit		(5,227,761)	(5,233,434)
Dividentët e paguar		(9,899,336)	(9,899,336)
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>100</b>	<b>(5,227,926)</b>	<b>(5,233,499)</b>
Rregullime jo materiale		150	150
Fitimi (humbja) e vitit		27,759,516	27,759,516
Dividentët e paguar		-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>100</b>	<b>22,526,067</b>	<b>22,526,167</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Pasqyra e flukseve monetare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

		31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>I. Fluksi monetar nga veprimtaria</b>			
Fitimi pas tatimit		34,043,310	(4,481,105)
Rregullime për:			
Amortizimin		3,186,259	3,507,051
Shpenzimet e tatim fitimit		(6,283,793)	(752,329)
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</b>		<b>30,945,776</b>	<b>(1,726,383)</b>
Pakësim/(rritje) në tepricën e aktiveve financiare afatshkurtra	5	4,714,634	22,158,495
(Rritje)/(pakësim) në tepricën e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra	6	(18,679,704)	(1,865,206)
Pakësim në tepricën e detyrimeve për t'u paguar	10	15,564,836	(4,574,577)
Rritje/(pakësim) në grante dhe të ardhura të shtyra	11	(75,685)	(100,914)
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>32,469,856</b>	<b>13,891,414</b>
Tatim fitimi i paguar	7	-	-
<b>Fluksi neto monetar nga (përdorur në) / veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>32,469,856</b>	<b>13,891,414</b>
<b>II. Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit</b>			
Shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	8	52,890	-
Blerja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	8	(1,377,657)	(1,615,875)
<b>Fluksi neto monetar përdorur në veprimtaritë e investimit</b>		<b>(1,324,767)</b>	<b>(1,615,875)</b>
<b>III. Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit</b>			
Dividentët e paguar		(9,399,278)	(11,760,514)
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e financimit</b>		<b>(9,399,278)</b>	<b>(11,760,514)</b>
<b>IV. Rritja/(pakësimi) neto i mjeteve monetare, neto</b>		<b>21,745,811</b>	<b>515,025</b>
<b>V. Mjetet monetare në fillim të periudhës</b>	4	<b>4,823,855</b>	<b>4,308,830</b>
<b>VI. Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	4	<b>26,569,666</b>	<b>4,823,855</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 6 – 16 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

### 1. Informacion i përgjithshëm

PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k. (referuar si "PwC Consulting" ose "Shoqëria") është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 15 korrik 2009. Bazuar në dokumentat e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 100 Lekë. Shoqëria është e regjistruar me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë me NIPT K91915023A.

Aktiviteti i Shoqërisë konsiston në kryerjen e shërbimeve të auditimit dhe të konsulencës financiare dhe fiskale të cilat filluan të ofrohen nga Shoqëria në nëntor 2009. Nga data 3 Korrik 2020 Shoqëria nuk kryen shërbime auditimi.

Adresa aktuale e Shoqërisë është: Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, Godina nr.5, Zyra 1/ Kati 9.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është 36 (viti 2019: 61).

### 2 Politikat kryesore kontabël

#### 2.1.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara në Shqipëri.

Ekzistenca e Koronavirusit të ri (Covid-19) u konfirmua në fillim të vitit 2020 dhe tashmë është përhapur përtej kufijve të Kinës duke i dhënë një goditje të fortë biznesit dhe ekonomisë botërore në tërësi. Duke qenë se kjo situatë është ende në progres, Dega në këtë kohë, nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një vlerësim sasior të ndikimit. Më tej, më 12 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli përhapjen e COVID-19 si pandemi globale. Në përgjigje të pandemisë, autoritetet shqiptare zbatuan masa të shumta duke u përpjekur të kufizojnë përhapjen dhe ndikimin e COVID-19, të tilla si ndalimet dhe kufizimet e udhëtimit, karantinat, urdhrat e strehimit dhe kufizimet në aktivitetin e biznesit, duke përfshirë edhe mbylljet. Këto masa, ndër të tjera, kanë kufizuar rëndë veprimtarinë ekonomike në Shqipëri por edhe atë globale për një periudhë të panjohur kohore.

Efektet e ardhshme të situatës aktuale ekonomike dhe masat e mësipërme janë të vështira për t'u parashikuar dhe pritjet dhe vlerësimet aktuale të menaxhimit mund të ndryshojnë nga rezultatet aktuale.

#### 2.1.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### 2.1.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 2.1.4 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrujnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

### 3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

#### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Paraja dhe ekuivalentët e parasë*

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

#### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

### 3.3 Aktive afatgjata materiale

#### *(i) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.



# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

### (ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

### (iii) Amortizimi

a) Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe përqindjet e amortizimit për secilën kategori aktivesh afatgjata për periudhën aktuale janë si më poshtë:

Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të tjera aktive	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Përmirësim në Qiramarrje	Mbi vlerën kontabël neto	5%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

b) Amortizimi i aktiveve afatgjata jo-materiale llogaritet mbi jetën e vlerësuar të aktivitetit duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Metoda dhe përqindja e amortizimit për kategorinë e aktiveve afatgjata jo-materiale paraqitet si më poshtë:

Programe kompjuterike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
-----------------------	--------------------------	-----

## 3.4 Zhvlerësimi

### (i) Aktivitetet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### (ii) Aktivitetet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

### 3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

### 3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove perkatëse.

### 3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit.

## 4. Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente

Mjetet monetare janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>Llogari rrjedhëse</b>		
Lekë	1,695,715	996,658
Euro	24,386,972	3,344,495
	<b>26,082,687</b>	<b>4,341,153</b>
<b>Arka</b>		
Lekë	225,299	248,272
Euro	261,680	234,430
	<b>486,979</b>	<b>482,702</b>
<b>TOTAL</b>	<b>26,569,666</b>	<b>4,823,855</b>

## 5. Aktive financiare afatshkurtra

Aktivet financiare afatshkurtra janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Klientë – të tretë	37,661,625	41,335,684
Klientë – palë të lidhura	19,429,305	18,795,306
Të arkëtueshme nga personeli	900,018	2,574,592
<b>TOTAL</b>	<b>57,990,948</b>	<b>62,705,582</b>

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

### 6. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra janë përbërë si më poshtë:	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Parapagime për klientët	23,885,701	3,106,148
Shpenzime të shtyra	2,821,539	3,123,747
Garanci	789,888	789,888
<b>TOTAL</b>	<b>27,497,128</b>	<b>7,019,783</b>

- Zëri "Shpenzime të shtyra" përfshin shpenzime që i përkasin vitit pasardhës në lidhje me sigurimet e përgjegjësisë dhe të aktiveve të Shoqërisë, pranë shoqërive të sigurimit Sigma Interbalkanien Viena Insurance Group dhe SIGAL sh.a., sipas policave të sigurimit dhe periudhave.

- Zëri "Garanci", përfshin garanci –parapagim për muajin e fundit të kontratës së qirasë së zyrës.

### 7. Parapagim tatim-fitimi

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Gjendja më 1 janar 2020	1,797,492	725,943
Parapagime gjatë vitit	1,211,542	1,823,878
Shpenzimi i tatim-fitimit	(6,283,794)	(752,329)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(3,274,760)</b>	<b>1,797,492</b>

### 8. Aktivet afatgjata materiale

Aktivt afatgjata materiale më janë përbërë si më poshtë:

Kosto historike	Përmiresim në qiramarrje	Mobilje dhe Orendi	Pajisje Informatike	Të tjera	TOTAL
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>8,103,072</b>	<b>6,792,858</b>	<b>22,637,565</b>	<b>4,961,709</b>	<b>42,495,203</b>
Shtesa	-	-	1,172,272	-	1,172,272
Pakësime	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>8,103,072</b>	<b>6,792,858</b>	<b>23,809,837</b>	<b>4,961,709</b>	<b>43,667,532</b>
Shtesa	-	318,025	1,059,703	-	1,377,728
Pakësime	-	172,938	-	-	172,938
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>8,103,072</b>	<b>6,938,002</b>	<b>24,869,540</b>	<b>4,961,709</b>	<b>44,872,322</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>					
<b>Me 31 dhjetor 2018</b>	<b>(1,638,680)</b>	<b>(5,027,434)</b>	<b>(14,658,015)</b>	<b>(3,454,247)</b>	<b>(24,778,375)</b>
Shtesa	(327,923)	(379,439)	(2,143,002)	(300,291)	(3,150,654)
Pakësime	-	-	-	-	-
<b>Me 31 dhjetor 2019</b>	<b>(1,966,603)</b>	<b>(5,406,872)</b>	<b>(16,801,017)</b>	<b>(3,754,537)</b>	<b>(27,929,030)</b>
Shtesa	(306,823)	(336,248)	(1,940,326)	(262,377)	(2,845,774)
Pakësime	-	(120,048)	-	-	(120,048)
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>(2,273,426)</b>	<b>(5,623,072)</b>	<b>(18,741,343)</b>	<b>(4,016,914)</b>	<b>(30,654,756)</b>
<b>Vlera kontabël Neto</b>					
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>6,136,469</b>	<b>1,386,042</b>	<b>7,008,820</b>	<b>1,207,172</b>	<b>15,738,503</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>5,829,645</b>	<b>1,314,929</b>	<b>6,128,197</b>	<b>944,795</b>	<b>14,217,566</b>

### 9. Aktivt afatgjata jomateriale

Aktivt afatgjata jo-materiale përbëhen si më poshtë:

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare  
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020  
(shumat në Lekë)

Kosto historike	Programe kompjuterike	TOTAL
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>2,517,076</b>	<b>2,517,076</b>
Shtesa	443,546	443,546
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>2,960,622</b>	<b>2,960,622</b>
Shtesa	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>2,960,622</b>	<b>2,960,622</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>		
<b>Më 31 dhjetor 2018</b>	<b>(1,255,286)</b>	<b>(1,255,286)</b>
Shtesa	(356,401)	(356,401)
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(1,611,687)</b>	<b>(1,611,687)</b>
Shtesa	(340,487)	(340,487)
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>-1,952,174</b>	<b>-1,952,174</b>
<b>Vlera kontabël Neto</b>		
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,348,935</b>	<b>1,348,935</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,008,448</b>	<b>1,008,448</b>

## 10. Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet

Detyrimet për t'u paguar dhe parapagimet janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitorë palët e lidhura	75,233,282	53,140,830
Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura	10,694,099	9,979,282
TVSH për t'u paguar	1,165,153	2,300,233
Furnitorë	2,726,241	12,345,609
Detyrime tatimore në lidhje me personelin	1,535,002	2,254,168
Detyrime për tatime në burim	1,985,724	1,946,896
Furnitorë për fatura të pambërritura	719,013	182,005
Detyrime ndaj personelit	91,456	53,456
Detyrime të tjera	1,492,618	1,150,125
<b>TOTAL</b>	<b>95,642,590</b>	<b>83,352,602</b>

Zëri "Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura" përbëhet nga detyrimi ndaj PricewaterhouseCoopers Bulgaria për paradhënie të marra prej saj për financimin e aktivitetit në shumën 10,694,099 Lekë (31 dhjetor 2019: 9,979,282 Lekë). Më parë detyrimi ishte ndaj PricewaterhouseCoopers Bulgaria, si Shoqëri mëmë në Bullgari.

## 11. Grantet dhe të ardhurat e shtyra

Grantet dhe të ardhurat e shtyra me 31 dhjetor 2020 në shumën 227,056 Lekë (2019: 302,741 Lekë) përfshijnë grantet në lidhje me pajisjet informatike (routers) marrë falas nga Shoqëria dhe pajisjeve celulare të marra falas nga Telekom Albania sha., të cilat amortizohen në të ardhurat e periudhës në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas jetëgjatësisë së aktivitetit dhe në përputhje me metodën e amortizimit përkatës.

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 (shumat në Lekë)

### 12. Shitjet neto

Të ardhurat nga shitjet rezultojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shërbime konsulence	119,132,269	123,948,379
Shërbime auditimi	90,581,201	78,176,926
<b>TOTAL</b>	<b>209,713,470</b>	<b>202,125,305</b>

### 13. Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit, rezultojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të ardhura të tjera	547,690	184,075
Të ardhura të tjera nga interesi	75,685	272,480
Telefonatat personale të punonjësve	16,215	110,669
Të ardhurat e shtyra		100,914
<b>TOTAL</b>	<b>639,590</b>	<b>668,138</b>

### 14. Materialet e konsumuara

Materialet e konsumuara rezultojnë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shpenzime energji / ujë	510,028	772,310
Materiale pastrimi	165,093	242,880
Kancelari	264,629	612,255
<b>TOTAL</b>	<b>939,750</b>	<b>1,627,445</b>

### 15. Kosto e punës

Kostoja e punës është përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Paga	72,002,448	86,274,075
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,946,549	10,493,076
<b>TOTAL</b>	<b>80,948,997</b>	<b>96,767,151</b>

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 (shumat në Lekë)

### 16. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Shërbime konsulence nga të tretë	27,364,501	31,085,561
Shpenzime rrjeti	32,921,603	25,264,420
Qira zyresh	8,147,204	9,464,966
Transferime, udhëtime, dieta	2,162,721	9,695,475
Shpenzime postare, telekomunikacioni	2,713,279	2,288,145
Shpenzime sigurimi	3,144,606	3,910,961
Shpenzime transporti	1,318,233	3,265,806
Trajnime personeli	1,181,426	3,777,886
Mirëmbajtje dhe riparime	2,773,310	3,370,052
Shpenzime përfaqësimi	2,222,645	985,900
Shpenzime të tjera për personelin	362,883	1,635,443
Shërbime ligjore, noteriale, perkthimi	293,704	2,410,346
Shpenzime konsumi për zyrë	702,168	877,057
Penalitetet, gjopa, dëmshpërblime	2,182,578	1,223,362
Shpenzime për shërbimet bankare	776,418	559,919
Qira të tjera	93,522	234,948
Tatime të tjera	49,500	45,000
Shpenzime rekrutimi	1,017	18,498
Të tjera	2,385,882	3,716,548
<b>TOTAL</b>	<b>90,797,200</b>	<b>103,830,293</b>

Zëri "Shpenzime konsulence nga të tretë" përfshin shërbime konsulence nga palë të treta në lidhje me projekte të përbashkëta. Zëri "Të tjera" përfshin shpenzime shpenzime të tjera zyre, të papërfshira në zërat e tjerë.

### 17. Fitimet/(Humbjet) nga kursi i këmbimit, neto

Humbjet neto nga kurset e këmbimit janë përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fitime nga kursi i këmbimit	216,260	20,077
Humbje nga kursi i këmbimit	(653,804)	(1,562,686)
<b>TOTAL</b>	<b>(437,544)</b>	<b>(1,542,609)</b>

### 18. Palë të lidhura

Në datën e bilancit, shumat e mëposhtme u korrespondojnë palëve të lidhura:

Detyrime afatshkurtra ndaj palëve të lidhura:	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
CT-Australia	1,375,198	688,391
CT-Luxembourg	1,410,649	730,351
CT-PwC Sevices BV	30,947,783	23,449,293
PL-PwC POLska Sp.z.o.o.	943,074	4,117,453

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

PricewaterhouseCoopers Bulgaria EOOD	10,694,099	9,979,282
HR-PwC d.o.o	1,187,519	182,743
PricewaterhouseCoopers Magyarorszag kft	5,643,778	62,120
SK-PwC CEE Firm Services sro	20,206,675	15,262,307
RU-ZAO PwC Audit	1,137,231	1,037,686
RS-PwC DOO Beograd	4,431,231	3,274,876
SK-PwC Slovensko sro	1,364,724	1,090,722
PricewaterhouseCoopers IT Services s.r.o	2,726,238	2,683,702
PWC Consulting DOO Beograd	166,995	164,390
PricewaterhouseCoopers LLC SDC Lviv Ukraine	684,469	-
PwC Service Delivery Center Kolkata private limite	16,332	-
PwC Service Delivery Center Poland s- SDC Katowice	365,114	-
RO-PwC Audit srl	150,543	-
CZ-PwC Audit s.r.o.	48,106	-
CT - United Kingdom	342,924	337,573
PwC Business Solutions B.V.	2,084,701	59,223
<b>Total</b>	<b>85,927,381</b>	<b>63,120,111</b>

<b>Të arkëtueshme afatshkurtra nga palët e lidhura:</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
PricewaterhouseCoopers AG Switzerland	6,022,307	3,750,691
PricewaterhouseCoopers Consult	2,942,294	2,896,387
PricewaterhouseCoopers LLP	953,618	1,318,471
PricewaterhouseCoopers Service	467,198	361,130
PricewaterhouseCoopers Belasti	-	361,135
PricewaterhouseCoopers Kosovo	-	1,121,334
Martins & Associados Advogados	-	54,797
PricewaterhouseCoopers Business	-	121,770
PricewaterhouseCoopers Legal	-	116,665
PricewaterhouseCoopers	-	267,736
PricewaterhouseCoopers Polska SP zoo	719,809	1,597,800
PricewaterhouseCoopers Eastern	302,035	-
Landwell & Associates	-	243,540
PricewaterhouseCoopers	178,128	-
PricewaterhouseCoopers Audit ood	3,936,012	3,776,697
PricewaterhouseCoopers Hungary	-	1,352,743
PricewaterhouseCoopers Ceska	-	152,213
PricewaterhouseCoopers LLP UK	592,475	583,231
PricewaterhouseCoopers d.o.o.	724,672	713,365
Landwell & associates	-	5,601
PRICEWATERHOUSECOOPERS SpA	618,500	-
PricewaterhouseCoopers Könyvvi	622,953	-
Ohrlings PricewaterhouseCooper	210,290	-
<b>Total</b>	<b>18,290,289</b>	<b>18,795,306</b>

# PricewaterhouseCoopers Consulting sh.p.k.

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(shumat në Lekë)

---

### 19. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, PwC Consulting mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekt negativ në pozicionin financiar ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2020, Shoqëria nuk ka angazhime të kontraktuara por ende të papaguara.

### 20. Ngjarje të mëpasshme

Ndërsa pandemia e Covid-19 vazhdon, qeveria shqiptare po zbaton masa shtesë për të adresuar çështjet aktuale të shëndetit publik dhe ndikimin në ekonomi. Dega ka vlerësuar se një ngjarje e tillë që vazhdon të ekzistojë, nuk kërkon ndonjë rregullim dhe rishikim tjetër të informacionit të raportuar në pasqyrat financiare të vitit 2020. Nuk ka ngjarje të tjera përveç sa më sipër, mbas datës së raportimit të cilat mund të kërkojnë rregullime apo paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.



**Emri I shoqerise:** PricewaterhouseCoopers Consulting shpk shpk

**Adresa:** Rr: Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Apt 9/1

**NIPT/NUIS:** K91915023A

**Viti 2020**

**Inventari I mjeteve te transportit ne pronesi**

Per analize te inventarit dhe materialeve sipas politikave fiskale te aplikueshme ne republiken e Shqiperise, ju lutem referojuni tabelës se meposhtme:

						Monedha ne lek
Nr	Artikull	Njesia	Sasia	Kosto	Vlera	
1					-	
2					-	
3					-	
4					-	
5					-	
6					-	
<b>Totali</b>						-

Shenim: Shoqeria nuk ka ne pronesi mjete transporti.

  
PwC Consulting Shpk  
Administratori



**Emri I shoqerise:** PricewaterhouseCoopers Consulting shpk

**Adresa:** Rr: Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Apt 9/1

**NIPT/NUIS:** K91915023A

**Viti 2020**

**Gjendja e inventarit dhe mallrave me 31.12.2020**

Per analize te inventarit dhe materialeve sipas politikave fiskale te aplikueshme ne republiken e shqiperise ju lutem referojuni tabelës se meposhtme:

Nr	Artikull	Njesia	Sasia	Kosto	Monedha ne lek	
					Vlera	
1						-
2						-
3						-
4						-
5						-
6						-
<b>Totali</b>						-

Shenim: Shoqeria ne aktivitetin e saj nuk perdor mallra dhe materiale



PwC Consulting Shpk  
Administratori



Emri I shoqerise: PricewaterhouseCoopers Consulting shpk

Adresa: Rr: Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Apt 9/1

NIPT/NUIS: K91915023A

Viti 2020

**Aktivitet Afatgjata Materale me vlere fillestare 2020**

Nr	Sasia	Gjendja 31.12.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2019
1	Mobilje dhe orendi	6,792,914	318,025	172,938	6,938,001
2	Pajisje informatike	23,809,838	1,059,703	-	24,869,541
3	Permiresim ne qeramarrje	8,103,072	-	-	8,103,072
4	Te tjera	4,961,709	-	-	4,961,709
<b>Totali</b>		<b>43,667,533</b>	<b>1,377,728</b>	<b>172,938</b>	<b>44,872,323</b>

**Amortizim kontabel Aktive Afatgjata Materale 2020**

Nr	Sasia	Gjendja 31.12.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2019
1	Mobilje dhe orendi	(5,406,872)	(336,248)	(120,048)	(5,623,072)
2	Pajisje informatike	(16,801,018)	(1,940,326)	-	(18,741,344)
3	Permiresim ne qeramarrje	(1,966,604)	(306,823)	-	(2,273,427)
4	Te tjera	(3,754,537)	(262,377)	-	(4,016,914)
<b>Totali</b>		<b>(27,929,030)</b>	<b>(2,845,774)</b>	<b>(120,048)</b>	<b>(30,654,756)</b>

**Vlera kontabel neto Aktive Afatgjata Materale 2020**

Nr	Sasia	Gjendja 31.12.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2019
1	Mobilje dhe orendi	1,386,042	(18,223)	52,890	1,314,929
2	Pajisje informatike	7,008,821	(880,623)	-	6,128,198
3	Permiresim ne qeramarrje	6,136,469	(306,823)	-	5,829,646
4	Te tjera	1,207,172	(262,377)	-	944,795
<b>Totali</b>		<b>15,738,503</b>	<b>(1,468,046)</b>	<b>52,890</b>	<b>14,217,567</b>

**Aktivitet Afatgjata jo materiale 2020**

Nr	Sasia	Gjendja 31.12.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2019
1	Programe kompjuterike	2,960,622	-	-	2,960,622
<b>Totali</b>		<b>2,960,622</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2,960,622</b>

**Amortizim kontabel I aktiveve jo materiale 2020**

Nr	Sasia	Gjendja 31.12.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2019
1	Programe kompjuterike	(1,611,688)	(340,487)	-	(1,952,175)
<b>Totali</b>		<b>(1,611,688)</b>	<b>(340,487)</b>	<b>-</b>	<b>(1,952,175)</b>

**Vlera kontabel neto e aktiveve jo materiale 2020**

Nr	Sasia	Gjendja 31.12.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendja 31.12.2019
1	Programe kompjuterike	1,348,934	(340,487)	-	1,008,447
<b>Totali</b>		<b>1,348,934</b>	<b>(340,487)</b>	<b>-</b>	<b>1,008,447</b>

  
PwC Consulting Shpk  
Administratori

